

INTERVISTË ME ISA REXHA

Prishtinë | Data: 19 mars, 2019

Kohëzgjatja: 62 minuta

Të pranishëm:

1. Isa Rexha (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
4. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: Qysh tregova ma herët, pra, intervista është më shumë biografike. Kishim dashtë me fillu prej çka ju kujtohet prej kujtimeve t'juja ma të hershme? Familjen? Rrethin ku jeni rritë? Edukimin? Krejt çka mbani në mend edhe qyshdo e mbani në mend vetën.

Isa Rexha: Une kom ardhë prej ni fshati, Barilevë. S'pari po tregoj, jom i lindur me 17.01.1959-tën. Qysh 20 vjeçar kur jom regjistru në fakultetin ekonomik... nëpërmes fakutletit, kooperativës së studentëve jom punësu në Hotelin Grand, si punëtor i Grandit. Prej 05.02. '80-ës kom qenë punëtor i sigurimit deri me 14.03. 2004 në të vërtetë '83-ës ku e kom fitu statusin e punëtorit, po jo si punëtor i Grandit, po punëtor i SLOGA-s.

SLOGA e ka përfshi Grandin, ish Bozhurin, Reastaurant Beogradin, Villa Gërminë edhe ni hotel në Fushë Kosovë. 18 pika i ka pasë. Në SLOGA kom kalue në kontabilitet. Në '83-'84 kom qenë kontabilist i mjeteve themelore edhe inventarit t'imtë. Në '85-tën e kom marrë titullin likvidator kryesor në Kompaninë SLOGA. Kom bo pagesat, transferet e furnitorëve. Prej atuhit e deri në '89-ten i ka shti masat ktu Serbia në nivel të Sllogës. Une prapë nuk e kom hupë vendin e punës, kom vazhdu me punu si likvidator. Bash likvidator deri në '97-ën kur une vet e kom lshue.

Jo, nuk më kanë largue po vet e kom lshue. S'ma ka marrë mendja mo me punu me ta edhe jom i kyçun me kto organet tjera. Kur kom ardhë ma së pari në Grand është shumë interesant kur... sot po thom shumë hotele kanë ndoshta yje, edhe Grandi i ka pasë pesë yje, mirëpo kushtet t'cilat i ka pasë Grandi nuk ka shansë që i ka sot ni hotel, mos të thom për botë, ekziston mundësia por në Evropë nuk besoj.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë kushte kanë qenë ato? A mundesh me na përshkru pak?

Isa Rexha: Po. Ma së pari në bodrum... se te Grandi ktu mrena e ka kugllanën, bilardon, i ka tenisn, i ka... nejtse qat' katin aty ku osht' i ka lavatorën edhe në atë kat i ka pasë garderobën me banjo. Kanë qenë dy garderoba, janë bukur t'mdhaja... meqenëse duhet nëpërmes... me bo kërkesën për me inçizu aty, duhet me bo nëpërmes AKP-së se s'na lejojnë neve me bo inçizimin.

E dy garderoba t'mdhaja. Ka qenë për femra edhe ka qenë për mashkuj. Për femna prapë ka bo ndamje. Kuzhina ke pasë t'vetën, ku çdo kuzhinjer para se me hi në punë, qoftë edhe pastrusi nuk ka mujtë me hi në Grand nëse nuk osht' hi... ka pasë çdo sektor ka katër kabina, tush kabina. Osht' dashtë me hi me u pastrue, me vesh uniformën e vet për me ardhë në punë. Ose mysafiri nuk ka mujtë me hi në Grand... po flas për vitet e '80-ta se kom qenë sigurim vet. Nuk ka mujtë me hi në Grand deri në '89-tën nëse nuk i ka pasë këpucë të fshime, rrobat e hekurosta. Në farmerka s'ka pasë shansë me hi ose i pa rrumë me konë ose diçka.

Domethanë, kanë qenë kushtet fantazi. As pastrusi... me përjashtim administrata që s'ka pasë garderobë edhe s'ka pasë të posaçshme kabinat, tush kabinat. Tjertë, me pastrus, me kuzhinjer, me kamarier, me nikoqir, me t'gjithë, t'gjithë i kanë pasë të veçanta. Kanë pasë garderobën e vet. Kështu që, ka qenë diçka super super mirë. Mirëpo prej '89-ës...

Erëmirë Krasniqi: Nuk po ngutemi qaq. Qitash kadal kadale e ndërtojmë këtë pjesë...

Isa Rexha: Mirëpo, unë pa ndërpre jam ktu prej 05.02. '80-tes, pa ndërpre, me përjashtim '97- '99, 10 gusht '99.

Erëmirë Krasniqi: Kur tregoni mos u ngutni me mrri deri te '89-ta se po më intereson edhe atmosfera qysh ka qenë ktu. Çka keni punu? Çka keni bo? Na kallxutë kto shumë në pika të shkurta, po nëse mundesh me u ndal në detale, aq ma shumë detale qaq ma mirë për neve. Qitash kisha dashtë me u kthy te të '80-tat kur keni hi me punu edhe çfarë... s'po di çka kishim mujtë me vet.

Aurela Kadriu: Ndoshta veç me na kallxu çka ka qenë qai institucioni Kooperativa e Studentëve, prej qaty. Qysh iu ka pru Kooperativa e Studentëve edhe mandej qato tri vjet që keni punu si sigurim.

Isa Rexha: Po.

Aurela Kadriu: Çka keni pa gjatë punës t'juj?

Isa Rexha: Unë deshta se masi m'thatë ma tepër është biografi e shkova shumë në pika t'shkurta e përshkriva punën e...

Erëmirë Krasniqi: S'na intereson neve në pika të shkurta, na pernime kemi qef me u ndalë në detale se na përmes tregimit t'juj mundemi shumë ma shumë me kuptu...

Isa Rexha: Kooperativa e Studentëve edhe sot ekziston. Përballë ekonomikut edhe juridikut osht'...

Erëmirë Krasniqi: Pernime a?

Isa Rexha: Po, po.

Erëmirë Krasniqi: S'e pasna ditë.

Isa Rexha: Edhe sot ekziston.

Erëmirë Krasniqi: Kooperativë i thojnë a?

Isa Rexha: Tash qysh i thojnë nuk e di. Osht' ni ndërtesë e vogël te hymja te Juridiku-Ekonomiku [Fakulteti] që janë bashkë, e qajo ndërtesa n'ballë që osht' ni ndërtesë qaty ajo ka qenë Kooperativë e Studentëve. Ni Xhaferi ka qenë drejtor në atë kohë. Mirëpo, mu s'më ka interesu kush është, unë kom ardhë përmes Kooperativës së Studentëve ktu.

Erëmirë Krasniqi: Okej. A po ia nisim me, me qysh keni ardhë në Prishtinë? Po ia nisim qaty ma mirë, kallxona...

Isa Rexha: A qysh kom ardhë në Prishtinë...

Erëmirë Krasniqi: Qysh iu kujtohet Prishtina në qat' kohë?

Isa Rexha: Aaa, po une e kom pasë familjen ktu, ktu e kom pasë babën, nejtse nëse ka fillu...

Erëmirë Krasniqi: A ke fillu [i drejtohet kamerës]?

Besarta Breznica: Po.

Isa Rexha: Unë e kom pasë babën ktu. Ktyneherë i kanë thanë kovaç, po farkatarë ka qenë. Ka punu... ka pasë lokalit e vet te Xhamia e Llapit. Kështu që, une kohë mas kohe, mos të thom ma së paku ni herë në javë kom ardhë në Prishtinë. Kështu që, Prishtinën e kom njoftë edhe sa kam qenë në shkollë fillore në fshatin Barilevë, shkollën "Ali Kelmendi". Kom ardhë ktu në Prishtinë masandej e kom kry Gjimnazin "Xhevdet Doda" tash ku osht', ktu që osht' Katedralja e marune ka qenë "Xhevdet Doda" aty. Masanena jom regjistru në Fakultetin Ekonomik. Ka qenë ni drejtim, s'kanë qenë disa drejtime e tash janë bo, po ka qenë ni drejtim.

Menihere në vitin e parë, me të thanë t'vërtetën jom kanë i interesun po jo, mirëpo rrethi ma kanë imponue. Edhe kom ardhë në Hotelin Grand nëpërmes Kooperativës së Studentëve. Mue Grandi m'ka pagu po mjetet që unë u dashtë me i marr plus 20 përqind u dashtë Grandi me ia qit Kooperativës së Studentëve, Kooperativa e Studentëve prej atyne mjeteve e ka nal 20 përqindshin fitimin e vet, se qaq ka qenë atëherë domethanë përqindja që është dhanë. E ka marrë përqindjen e vet, 20 përqind, pjesën mbetjen m'i ka dhanë mu si pagë mujore. Kom qenë prej mujit t'dytë '80-tës deri në mujin e katërt. Me 13.04. '83-tën, ku me 13.04 e kom fitu statusin e punëtorit t'rregullt edhe kom kalue në nivel të SLOGA-s.

Mirëpo, sa kam qenë punëtor i Kooperativës së Studentëve, po flas kur kom hi në Grand [Hotel], për mu ka qenë, mos të thom... nuk po di as s'kom fjalë me përshkru. Ka qenë diçka tepër, tepër, tepër mirë. Ka qenë shumë serioz, kanë punu fort mirë, ka pasë mysafirë shumë, diciplina ka qenë n'rregull. Ka pasë njerëz të angazhum, po kanë qenë civil prej policisë, pos neve që ka qenë sigurimi jonë. Ka pasë edhe njerëz civil që kanë shëtitë ksajde për me mbajtë rendin edhe qetësinë në Grand. Ka pasë... i vetmi hotel ka qenë në Kosovë që kanë ardhë kështu mysafirë t'jashtëm...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë mysafirë? Prej krejt Jugosllavisë a...

Isa Rexha: Prej krejt botës. Ja, ja po flas për krejt botën, jo prej Jugosllavisë. Prej krejt botës ka pasë mysafirë ktu. Prej krejt botës edhe tulifare. Ka qenë ni aspekt shumë lirshëm me qujt Oda e Kosovës, se

njerzhtë... sikur sot që e kemi Swiss Diamond për shembull... me ambasadora, me kryetarë t'shteteve e kto. Në katin e tretë edhe të katërtin e sidomos në të katërtin osht' punue vetëm personalisht për Titën.

Erëmirë Krasniqi: Për Titon?

Isa Rexha: Po, ju me siguri e keni nie, s'e keni njoftë. Unë kom pasë rastin edhe me pritë ktu kur ka ardhë Tita. Kati i katërt edhe quhet Rezidenca e Titës edhe sot. Edhe sot quhet Rezidenca e Titës ajo pjesë. Po... nejse kthehna une prapë ku isha, po po t'thom që n'atë Rezidencën e Titës, në kohën para luftës, tash, edhe kohës gjatë luftës udhëheqësia që kanë dirigjue ushtrinë, policinë në kohën e luftës nuk kanë qëndru në polici atje po kanë qëndru ktu në Grand. Edhe prej ktuhit i kanë dhanë direktivat, bash prej Rezidencës të Titës. E tash për sigurim, s'di çka me të thanë ka qenë pa kurfarë problemi s'kom pasë kurrë asni problem t'vogël, qaq ka qenë siguria...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë rutina ju? Qysh ka qenë rutina e punës t'ju?

Isa Rexha: Ka qenë... puna ime ka qenë prej orës 17:00 masdite deri në 04:00 t'mëngjesit domethanë... se jom kanë edhe student, dojsha edhe me msue, po ka qenë qajo. Dikur kem kalu prej orës 21:00 deri në 04:00 prapë. Për shkak që m'u dufke për provime, m'u dufshin për ligjerata do kohë e qishtu. Kështu që, kom punue. Mirëpo, kur e kom vrejtë une ktu se çdo sektor i veti, çdo sektor i Grandit, kuzhina, kamariertë i kanë garderobat e veta, i kanë... në atë kohë, tush kabinat e veta.

Kur kem vrejtë që edhe pastruesi i cili punon shumë thjeshtë i mbledh mbeturinat që bohen tonë ditën apo diçka, nuk ka mujtë me dalë në sallë apo në koridor të Grandit pa hi me bo ni tush, me vesh garderobën e punës edhe me dalë në punë me garderobë t'lane. Jo me dalë qyshdo e me hi, se për kuzhinier e për kamarier mos të flasim. Domethanë, ka qenë shumë rregull, shumë njerzë kanë qenë kështu.

Në 13-tin kat është ni restaurant, osht' qujt Restaurant Panorama, ku shifet mos të thom gati... tash osht' zgjanu Prishtina, po në atë kohë u pa krejt Prishtina prej atij katit aty. E tani kom vazhdue me 13.04 e kom fitue statusin e punëtorit t'rregullt...

Erëmirë Krasniqi: Deshta qitu me u nalë, çfarë qyteti ka qenë Prishtina në atë kohë? A ka qenë i sigurtë kur keni punu ju ktu në sigurim? Nifarë forme e keni pasë edhe nifarë si vetëdije për sigurinë në qytet në përgjithësi?

Isa Rexha: I sigurtë ka qenë deri dikund, po jo se në '81-tën me 11 prill, me 11 mars në '81-tën edhe vet kom qenë student edhe vet kom marrë pjesë në demonstrata të '81-tës. Me 1 prill, me 2 prill, me 26 mars kur janë kanë, në të gjitha demostratat kom marrë pjesë si student. Mirëpo, ktu mrena në Grand, po ktu mrena në Grand ka qenë nifarë sigurie ma e madhe. Meqenëse neve nuk na kanë pengue, neve nuk na kanë pengue. S'kanë hi as protestuesit, po as nuk është rritë vëzhgimi i policisë mrena në objekt gjatë kohës së demonstratave.

Kanë qenë dy vetë, nifarë Xhaferi, shqiptarë kanë qenë, s'po më kujtohet emri i ktij tjetri, nëse s'gabo Sali. Dy vetë që tonë kohën, pat e s'pat demonstrata domethanë kanë qenë prezent ksajde nëpër Grand

janë sillë, po edhe gjatë demonstratave nuk është rritë që me thanë po vijnë ma tepër p'e kontrollojnë apo po kqyrin. Po edhe protestustë nuk kanë hi në Grand, demonstruesit në atë kohë. Nuk kanë hi në Grand që me thanë t'i pengojmë apo t'thejmë diçka apo... as s'kanë thy, as s'kanë pengu. Puna osht' kry ktu shumë normal, sikur kur s'ndodhë kurgjo. Me përjashtim që na kemi pa çka po ndodhë, mysafirët e kanë vrejt.

Në atë kohë nuk ka pasë vend për gazetarë të jashtëm që i kanë përcjellë demonstratat e '81-tës, nuk ka pasë vend ktu. Meqenëse, në '81-tën na lajmrin... u bo ora policore edhe na e kemi pasë mas orës 8:00 në mramje deri në 5:00 të mëngjesit... se kuzhina ka punu për shembull deri në ora 24:00, shansë me dalë s'kanë pasë. U dashtë me iu siguru fjetje ktu, dhoma, kanë fjetë ktu punëtortë. Mirëpo, ka pasë edhe shumë gazetarë, po flas për krejt botën, prej Jugosllavisë ata harro, pak ka pasë. A ka pasë shumë gazetarë. Kështu që, pak ma heret e thashë, ka qenë oda edhe krejt janë mledhë ktu, i kanë përcjellë demonstratat t'jashtme çka kanë qenë krejt ktu janë kanë... knap ka qenë gjithmonë, ka pasë punë, rrogat...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë për juve se ju paskët qenë edhe student. Keni majtë sigurim edhe ktu po në të njejtën kohë si student keni qenë në protesta atje. Qysh ka qenë me e pasë këtë farë jete të dyfishtë në atë kohë?

Isa Rexha: Po kqyre tash, do që ishin në punë iu interesojke ku ke e çka bone, ku ket', qysh ket', a ju nxunën najkund a diçka, mirëpo ka qenë atëherë shumë interesant për neve, shumë interesant...

Erëmirë Krasniqi: A nuk bijke qajo në konflikt?

Isa Rexha: Me punë ktu?

Erëmirë Krasniqi: Aha.

Isa Rexha: A jo, jo, jo, jo, s'më ka... jo, jo, jo. Asni kokërr. Jo, me punë jo. S'kom pasë prej kërkujna që me thanë diçka najfarë, "Pse ke a, pse s'ke a, ke a?" Përkundrazi kanë pytë, "Qysh kalutë sot? A pat' naj problem? A murren dikond? Kond e murrën? Ku ke ma kallabllak? Ku kenë problemet ma t'mdhaja?"

Erëmirë Krasniqi: E ku kanë qenë, a po na tregon?

Isa Rexha: Po ma s'pari kur janë nisë kanë qenë te Menza e Studentëve, te Menza e Studentëve po ma së shumti kanë qenë ktu mas teatrit, ka teatri ksajde kanë qenë... githmonë kanë qenë ma t'mdhajat edhe kah Menza e Studentëve. Ato gjithmonë jonë kanë ma të mdhajat, mas teatrit edhe kah Menza e Studentëve.

Erëmirë Krasniqi: Kur erdh policia, po menoj edhe ushtria që erdhën me e ndalë këtë farë shpërthimi nacionalist qysh e kanë përshkru atëhere, çka bojshin studentët? A të kujtohet?

Isa Rexha: Po, protesta kem bo gjithmonë...

Erëmirë Krasniqi: Se ka qenë shumë krizë e madhe fakti që forcat jugosllave kanë ndërhy në Kosovë në qasi forme për me ndalë ni protestë edhe nuk kanë shkru shumë. Për shembull, Rilindja nuk shkrun hiç për protesta. Qysh ka qenë e komunikume krejt çka është tu ndodhë rreth asaj proteste?

Isa Rexha: Po në atë kohë krejt i kanë qujtë, po mos të thom edhe shqiptartë çka kanë qenë në udhëheqësi i kanë qujtë nacionalistë. Kta në të vërtetë, po thom na kemi lypë të drejtat tona, kemi lypë ni lloj republike në atë kohë ish... kemi qenë me ni autonomi po kemi lypë republikë si të gjitha republikat tjera. Na kanë qujtë gjithmonë nacionalistë, vetëm pse kemi pasë... pse kemi qenë shqiptarë. Kanë ardhë me polici... ushtria kshtu nëpër rrugë s'ka dalë, policia po. Prej të gjitha republikave kanë ardhë edhe prej Sllovenie edhe prej Kroacie. Dikur ma vonë prej Sllovenie edhe Kroacie u tërhoqën policia se fillunë tani ndamjet e brendshme të Jugosllavisë. Kështu që, atëherë ka pasë edhe të dënum shumë...

Erëmirë Krasniqi: A ju penalizun juve naj qysh si student meqenëse keni marrë pjesë?

Isa Rexha: Jo, jo, në asni mënyrë. Unë në fshatin Besi në qat' kohë kom katër kusheri të ciltë ni kamionit ia marrin dikun për afërsisht nëse nuk gaboje përmi një mijë armë automatike në Besi. Kështu që, tani ata i kanë majtë në burgje me kah 14 vjet, 15 vjet në burgje i kanë majtë.

Erëmirë Krasniqi: Pse ia kanë marrë?

Isa Rexha: Pse e nalën ni kamion, ai ish kanë plot me armë e ua kanë marrë e u armatos popullata në atë kohë. U armatos popullata në atë kohë. Sakt datën me ta thanë të vërtetën nuk di kur ka qenë, jo të saktë nuk e di kur ka qenë. Mirëpo, ata i kishin marrë shënimet, kështu që i kanë mledh natën. Kush i ka marrë krejt i kanë mledhë edhe i kanë majtë burgjet, po me thanë dikund nja 500 vetë po. Qaty në Besi që kanë marrë pjesë, kur e kanë nalë kamionin kur vjen prej Nishit po thom kështu, prej Serbie, kamion e ua kanë marrë armët.

Erëmirë Krasniqi: Ju na thatë që keni qenë ktu, kohë pas kohe keni ardhë në Prishtinë. Po kthehna pak ma herët, që keni ardhë me vizitu babën e juv të paktën niherë në javë. A ju kujtohet kur u ndërtu Grandi? Kur ka fillu ndërtimi?

Isa Rexha: E kom ni fotografi të Grandit po qe sot nuk e kom me veti, para përfundimit, para përfundimit.

Erëmirë Krasniqi: A jeni ju aty në fotografi apo vetëm objekti?

Isa Rexha: Jo, jo, vetëm objekti si objekt. A po thom se mas '84-tës, '83-tën ne jse '85-tën unë jom marrë me regjistrime, jom marrë me t'gjitha. Po edhe mas privatizimit, ma shumë kom ditë une për privatizimin se që ka ditë vetë pronari. Kom pasë kontratën e blemjes, domethanë t'shitjes të AKP-së, ne jse të blemjes që e ka pasë ky pronari. Janë bo shumë ktu do farë dallimesh, janë bo do ndryshime t'mdhaja prej privatizimit, po sidomos prej kur kanë hi masat e dhunshme '89-tën ka ndryshu me t'madhe Grandi.

Ato garderoba nuk funksionojnë, tush kabinat nuk funksionojnë janë shkatërrue. Në kohën kur e ka marue ktu ma së pari Grandi, po të thom, leje për ndërtim sot nuk ka. Lejen e ndërtimit Grandi nuk e

ka. Projekti si projekt ekziston vetëm me etazha, me kate. Në arkivë të Kosovës me shkue e gjeni vetëm me kate. Ky projekt është punue... projektues i këtij ka qenë Matej Rodiqi

Erëmirë Krasniqi: Bashkim Fehmiu?

Isa Rexha: Ka qenë edhe Bashkimi, po Matej Rudiqi ka qenë kryesori që i ka punue krejt kto edhe ka qenë në kontrollën e ktyne, është shqiptar.

Erëmirë Krasniqi: Ai ka qenë si piktor apo?

Isa Rexha: Po, po piktor po ka qenë shqiptar po në Kroaci ka jetue. Ky projekt është punu për Dubrovnik, nuk kanë mujtë me ia gjetë vendin edhe tash Tita ka thanë me çue ktu. E kanë pru ktu qitu mrapa meniherë qikjo ndërtesa qitu ka qenë komanda e ish Ushtrisë Jugosllave për Kosovë. Edhe qitu ku osht' bo kjo pjesa ku osht' teatri ka qenë e parapame edhe është punu në atë kohë për ni përmendore të Titës. Hotelin e ka pasë ktu, dhomat i ka pasë ktu. Domethanë, dhoma e tina është sa është qiky koridor krejt, osht' dhoma e tina, mos të dhom përmi 200 metra katror është vetëm ni dhomë e tina. Lejën si leje nuk e ka të ndërtimit, s'e gjen, nuk gjen...

Erëmirë Krasniqi: Po, po çka iu kujtohet ma shumë prej qasaj periudhe? A ju kujtohet kur ka fillu me u ndërtu?

Isa Rexha: Jo se une kom qenë i vogël... po si m'u ndërtu po rasisht e kom gjetë ni fotografi ku osht' tu u maru Grandi, para përfundimit. Nëse nuk harroj ja u sjellë une atë fotografi.

Aurela Kadriu: Po e kur vishit ju qatëherë në Prishtinë me vizitu babën kur e shishi që po ndërtohet ni qisi hoteli i qisaj kategorie qysh u folke për to? Qysh e mbani në mend? Çka thojshin njerz të që Grandi po marohet?

Isa Rexha: Po kqyre tash me të thanë të vërtetën une atëherë kom qenë si fmi edhe fort neve na ka interesu ma shumë me lujtë në mes veti sesa me fol ktu. Mirëpo, tani kur kom fillu shkollën e mesme, kom fillu ktu gjimnazin kom banu te Xhamia e Llapit, domethanë çdo ditë kom kalu ksajde. Më kujtohet që baba thojke që ka qenë pus ktu edhe ka qenë treg i lopëve ktyneherë. Domethanë bash qikjo baza ku është ktu Grandi ka qenë nifarë pusi nifarë bazeni kështu që s'osht hi. As me lujtë s'kanë mujtë n'to edhe ka qenë treg i lopëve në atë kohë.

Mirëpo tani kur u maru Grandi... e ka maru Ramiz Sadiku osht' ndërtim i fortë, muret janë shumë të trasha, krejt janë të betonit, nuk ka kurgjo... për çdo rast nëse iu intereson mujna me dalë në atë pjesën ku ja ka dhanë atë farë fasaden e jashtme, mirëpo të brendshem është katastrofë. Janë muret, mos të thom ma tepër se gjysë metre të gjanë. Tash në atë kohë ka qenë standardi edhe vërtetë ka qenë i mirë. Ka qenë projekti që edhe sot ekziston që me u lidhë me qendrën sportive ish Boro e Ramizi që i kanë thanë ktynehere, që sallat e tyne me u shfrytëzu prej mysafirëve të Grandit edhe kto dyja me qenë si një.

Domethanë, Grandi edhe qendra sportive me qenë si ni organizatë. M'u shfrytëzu atje edhe mysafirët e atjehit me ardhë ktu edhe për kta osht' i parapamë ni mbikalim. Prej ktuhit osht' ni kat ma poshtë dalja prej salle, del atje kah Banka Qendrore tash që osht' ka qenë përpara SDK-aja. Mbikalimi m'u

maru aty i mbulun, me kalu te qendra sportive tash po thom Boro e Ramizi, që ka qenë përpara. Edhe sallat e tyne me u shfrytëzu edhe prej mysafirëve t'ktuhit po edhe mysafirët e atyne me ardhë ktu në Grand. Mirëpo s'jonë kry kurrë. Kto s'jonë kry kurrë. Ato lidhje nuk janë bo kurrë.

Erëmirë Krasniqi: Vazhdojmë me Grand se kisha dashtë, nëse munesh, veç me u kthy pak mbrapa te baba juj edhe dugoja si kovaç. Qysh ka funksionu në qat' kohë? Se po më doket interesant që e keni pasë babën në Prishtinë edhe ka qenë në pjesën e vjetër t'qytetit. A të kujtohet diçka prej pjesës t'vjetër edhe për qata zanatlitë? Me siguri ka pasë edhe tjerë edhe qysh ka qenë e organizune qajo pjesë e qytetit?

Isa Rexha: Po, po. Baba qysh i ri ka qenë shumë i interesun për punë private kështu ka punue. Ka qenë kovaç kështu po thom, kta pak ma të kulturum i kanë thanë farkatar. Ka marue kerret e para me rrota të drunit që kanë qenë ktynehere. Kanë maru do, kemi thanë na, nuk e di qysh i thojnë sot po qashtu i kanë kujtë edhe atëhere qëkërrka me ujitë bashqen, me ujit tokën. Domethanë është një prej kovaçve që i ka marue kerrin e hekrit ma s'pari edhe ka maru qato qëkërrkat për me ujit tokën, me kali e kanë sillë edhe ato kofet kanë qenë të lidhuna njëra mas tjetrës e ka nxjerrë ujtë dhe në atë qëkërrkun çdo njana e ka pasë bazenin e vet, kur osht' ardhë aty në vend osht' mush ujë u shku poshtë edhe ka ardhë naltë u shprazë. Ka qenë punëtor, kushtet i kena pasë, i kom katër vllazni, domethanë kurrë...

Erëmirë Krasniqi: A i keni ndihmu ju në qat' punën që e ka bo si farkatar?

Isa Rexha: A jo, jo, jo. Ai ka qenë shumë i interesun ka qenë për shkollim edhe e ka dashtë shkollën fort. Ni kohë kur ka qenë aksioni për mledhjen e pushkëve, atina tha... se edhe baba jem ka ditë shkrim-lexim çirilicë. Çirilicën e ka ditë mirë e vëllaun e madh, ku tash i ka 80 vjet... domethanë në atë kohë e ka çu se s'ka pasë Fakultet Juridik ktu e ka çu në Nish me kry Fakultetin Juridik. Domethanë e ka dashtë shkollën. Të gjithë vllaznin i kemi domethanë... baba na ka thanë, "Gjithçka çka doni mundësi keni veç shkollën me krye" domethanë në atë kohë.

Se kur ka qenë aksioni i pushkëve tregojke disa raste, për shembull kanë lypë pushkë prej meje edhe une kom thanë, "S'kom e s'kom e s'kom" e kanë çu në letër. E çoj qita, ta bjen qit letër, "Nxine rrehne se s'pe pranon pushkën". Baba e ka ditë çirilicën. Edhe kallxon me emra aty në fshat që filanit e filanit ia kanë dhanë letrën qishtu. Me letër t'vet u shku ia ka dorëzu policisë edhe e kanë rre. Tha, "Une e kom lexu edhe s'jom dorëzu se e kom asi..." edhe aty e ka dashtë msimin fort, arsimin e ka dashtë fort.

Edhe, mos të thom... ka vdekë në 2008-ën me mall se çka do të bohet me Kosovën hala, u kanë çka do t'bohet me Kosovën. Njiqind vjet tre muj e shtatë ditë ka jetu. Po shkollën e ka dashtë fort, si kovaç ka pasë pare na ka mundësu të gjitha kushtet. Tokën e kemi në fshat atje e kemi dikun, domethanë atje i ka pasë dikund afër tetë hektar. Ka pagu argatë me pare e neve s'na ka lanë me dalë në ara kurrë, veç mësoni, veç mësoni. Domethanë, t'gjitha, t'gjitha kushtet që sot s'besoj që i kanë shumica prej ktyne.

Erëmirë Krasniqi: Qato qëkërrkat që i kanë ndërtu për bashqe a kanë qenë shumë të kërkume në qytet a qysh?

Isa Rexha: Jo, në qytet por nëpër fshatra. Në qytet jo se ata kush ka punu bashqe...

Erëmirë Krasniqi: Se thojnë që edhe Prishtina ka pasë shumë bashqe për qata...

Isa Rexha: Lakrishtja u kanë. Po ata kanë mbjellë lakna shumë edhe i thojnë lakrishtë. Po për me ujit bashqen... nuk e di, si model ndoshta e gjoj ndonjë model për me fotografi si model. Në... s'di qysh me ua shpjegu do kofe kanë qenë e ato kur kanë ardhë kanë pasë djepin e vet kur kanë ra osht' derdhë ujë po me kso alumina e ka pasë bo qitjen e ujit jashtë bunarit edhe tani vike ujtë për me ujit bashqen nëpër tokë. Sistem pikë pikë atëherë s'ka pasë, as që është mendue që do t'ketë.

Po në '74-tën ka dalë ai në pension prej atëhershit e ka punu ai tokën. E ka punu edhe ma përpara po 80 përqind t'punës e ka punu me punëtorë, po edhe pensionin ni kohë e ka pasë t'mirë deri kur në '89-tën kur ma u prishën krejt. Atëherë ma s'ka pasë as pensione, as s'ka pasë kurgjo, ka pasë t'dobta pensionet. Mirëpo u bom na tanë nëpër puna, kështu që s'kish fort edhe ai nevojë... megjithëse krejtve i duhen paret, po ai s'kish nevojë se t'gjitha kushtet i kish. Tokën e punojke, lopë e kto majke për nevoja t'veta edhe qe besa për nevoja tonat. Kështu që, i kishim të gjitha kushtet, s'kish najfarë problemi.

Aurela Kadriu: Ku e ka pasë saktësisht a e mbani në mend ku e ka pasë dyqanin?

Isa Rexha: Po, po saktësisht. Tash e kanë do Bajgorë të Lupçit.

Aurela Kadriu: Ku osht'?

Isa Rexha: Te... Azem Fana u kanë kit' anë na jena kanë n'kit' anë. Qysh thirret ajo që e kanë kta të Lupçit? Pa shku te stacioni i autobusave te Xhamia e Llapit, domethanë nja 20 metra pa shku te stacioni i autobusave.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: E çfarë vendi ka qenë qai kur e ka pasë baba dyqanin?

Isa Rexha: Kanë qenë dy kovaçë. Njani ka qenë pak ma naltë, domethanë ka qenë pak përfundi ksaj shtëpisë së shëndetit që ktyneherë e kemi qujtë Ured. Domethanë u kanë shtëpi e shëndetit e kemi qujtë Ured, tash është diçka po më duket për penzionera nëse nuk gabo, s'osht' ma shtëpi e shëndetit ajo. Edhe ka qenë baba aty. Tjerë kovaç nuk ka pasë ktu në Prishtinë. Në kohën kur unë e maj babën n'mend që ka qenë kovaç aty. Ka qenë privilegj për to. Ka pagu atëherë sigurimin edhe pse ka qenë privat osht' dashtë me pague, si xehtar u dashtë me pague sigurimin. Kështu që, pensionin e ka pasë fort të mirë kur ka dalë në penzion. '74-tën po flas deri në... kur fillun në '89-tën ato me u prishë. Pensionin e ka pasë fantazi t'mirë, me siguri me t'gjitha i ka pasë. Po ai ka qenë shumë punëtor, shkollën e ka dashtë fortë.

Erëmirë Krasniqi: E zanatli tjerë afër tij a ka pasë?

Isa Rexha: Ka qenë ni magjup.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka bo ai?

Isa Rexha: Edhe ai ka qenë po i njejt.

Erëmirë Krasniqi: Farkatar?

Isa Rexha: Po. Kanë mreh sakica e kanë... ai s'ka ditë me maru kerre e kto ky ka maru kerre oi ky ka mreh edhe sopatat i kanë mreh kto senet. Kështu që, ka qenë shumë punëtor. S'ka pasë send që punohet... n'kohën e luftës domethanë '39-tën ai osht' nxanë ushtar ka qenë, '39-ten baba ka qenë ushtar. Thotë, "Kom qenë në Bjeli Manastir ushtar", tregojke... Ushtar i ish Jugosllavisë, po. Edhe kur ka fillue atëherë bombardimi gjerman mbi ish Jugosllavinë thotë, "Kom qenë tu lu me top". Edhe prej atuhit ai ka kalu, ma s'pari ka qenë partizan qysh i kanë qujtë kta tani e kanë nxanë kroatët, ka qenë me kroatët, tani e kanë nxanë çetnikët. Thotë, gjashtë muj ka qenë me çetnikë edhe ka qenë tani me '44-tën, '43- '44-tën me Shaban Polluzhën.

Erëmirë Krasniqi: Në Skenderaj.

Isa Rexha: Po. Tregon ni rast kur janë takue Shaban Polluzha edhe Fadil Hoxha në Llozhan, afër Podujevës. "Kur janë taku aty", thotë, "janë nda bukur keq n'mes veti. Edhe kta Fadili e kta janë kthye me ardhë për Prishtinë na kem fillue me shku anej p'i Drenicës". Edhe ka qenë tanaj, dy vjet ka qenë me Shaban Polluzhën.

Erëmirë Krasniqi: E mandej kur, kur u kry lufta ky e ka marr qat' profesion a po? Deri në '74-tën...

Isa Rexha: Ky profesionin e ka pasë edhe ma herët. E ka pasë ni lokal në katun aty në Barilevë, ka mreh sopata, ka maru diçka, ka shvajcit diçka. Edhe tani mas ni kohe e ka pasë në Babinmost, se na si komunë, si fshat i Barilevës kemi qenë me komunë të Vushtrrisë në atë kohë, kemi qenë me komunë të Vushtrrisë. Ky e ka marr me qira ni lokal në Babinmost. Në Babinmost pjesa dërmuese kanë qenë Serbë. Ka qenë edhe si komunë në veti Babinmosti përpara edhe aty ka pasë... mirëpo në të '60-ën e ka ble qaty ku e ka pasë te Xhamia e Llapit, domethanë unë jom '59-sh ai në të '60-ën e ka ble edhe ka çelë si lokal qaty punëtorinë e vet edhe ka punu si xehtar n'qat' lokal deri në '74-tën kur ka dalë në pension. Në '74-tën ka dalë në pension, po atë pjesë na e kemi shitë në '83-tën do Bajgorëve të Lupçit janë aty. Bajgor...

Erëmirë Krasniqi: E a u ka përcjellë ndonjë tregim prej Luftës të Dytë Botnore baba? Për shembull, kur ka luftu me Shaban Polluzhën. A ua ka kallxu naj skenë a naj storie a naj... ?

Isa Rexha: Po ka kallxu shumë. Ni ditë, ky rasi që ka ndodhë katër mijë vetëve në Bar [Tivar], ky të nesërmen domethanë qysh ai e përshkrujke, ka qenë mas tetë orëve ka mrri në Bar aty. "Prej Mitrovice na kanë nisë në kamë" thotë, "n'kamë". Ka qenë me vëllaun e dytë t'vetin bashkë. E unë i kom edhe dy mixhallarë të tjerë. Në të vërtetë njani u mbetë se tjetri ka vdekë, "Kena qenë bashkë edhe jena nda për mos me shku bashkë se jena tutë nëse është lodhë e s'ka mujtë me ecë ose osht' dashtë me i ra vëllaut ose ju ka ra dyve" atëherë nëse s'kanë mujtë me ecë nëse janë lodhë. E tregojke edhe kur kemi ecë,

“Prej Mitrovice kemi ecë deri në Shkodër pa nalë kurrë gati. E prej atuhit kemi mrri...” thojke, “në Bar...”

Erëmirë Krasniqi: E baba juj nuk ka qenë...

Isa Rexha: Ni ditë mrapa, tetë orë mrapa ka qenë në Bar. “Prej atuhit na kanë qit tani në do farë anijesh edhe kanë zbritë në Bosnje kanë hy”. Kur kanë hy në Bosnje atëherë janë nxanë. Do janë nxanë prej ustashëve kroatëve, do janë nxanë prej çetnikëve, do janë nxanë prej gjermanëve. Kështu që, aty krejt çka kanë qenë qysh tregojke ai që kanë qenë dikund afër dy mijë vetë janë nda në katër-pesë grupe edhe janë nxanë. Aty osht’ nxanë... baba qysh e tregojke osht’ nxanë prej çetnikëve. Por ky ka qenë si mjeshtër i kerreve e për me ia ndreqë ni qeze “Kosta Pacanoviçin e kom pasë komandant. Rrogën që e kom marrë prej tina” thojke, “20 anëtarë të familjes kom mujtë me i majt”.

Ni plakë boshnjake i ka ndihmue me ikë prej tyne, se s’ka ditë kah ku metë, qysh metë edhe ajo osht’ nda, e ka nda prej krejtve edhe kanë mbetë me ia ndreqë kerrin e qajo plakë... se dike me tregue. Ajo tregojke, “U kanë ni kodër...” u kanë kështu, u kanë ashtu e m’ka thanë, “Ik qitu, del aty”. Tani prapë e kanë nxanë gjermant. Tani prap ka qenë SS me këta gjermanët, mirëpo aty i ka pasë hjekat e veta. Mirëpo shnetën e ka pasë t’mirë edhe pse ka hjekë, shnetën e ka pasë t’mirë.

Aurela Kadriu: A kallxojke çka kish pa kur ka mrri në Bar mas tetë orëve?

Isa Rexha: Po. “Krejt ka qenë e mbulume...” thojke, “me veshje, me plisa, me shalla, me veshje kombëtare. Krejt deti ka qenë i mbuluen, që i kanë shty me bagera i kanë gju në deti”. Po. Ky e ka ditë serbishten kur ka ikë në ‘43-tën, kur ka ikë p’i gjermanve... se e kishin pasë pru gjermant në Kralevē me punu, fizikisht. Edhe i ka thanë, “Kom nevojë për...” nevoja t’veta edhe u dalë malit edhe ka ikë. Po ky ka ikë edhe thotë, “Kom shkue...” e tregojke me ara, me vend duket qishtu, duket qishtu edhe ka ra te ni serb. Thotë, “Ia kom dhanë teshat e mia...” domethanë që i ka pasë t’veshun të ushtrisë, “ia kom dhanë teshat” edhe ia ka dhanë ai do tesha t’veta t’shkive. Mirëpo ky e ka ditë serbishten mirë, ka thanë, “Jo se jom serb i Kosovës. Jetoj në Kosovë”. Ia ka dhanë veshjet për me ardhë, deri kur ka ardhë për me hy në Mitrovicë.

Në Mitrovicë kur ka hy ka hy me veshje t’serbëve, p’i trenit kur ka zbrit, ka hi me veshje t’serbëve. Po flas qysh ka thonë ai. Edhe kur ka hy në Mitrovicë nja katër veta shqiptarë me veshje kombëtare, me pushka në krah, tha, “Më përcillshin ku po hin qiky te likuidojmë. Atëherë...” tha, “unë as nuk guxojsa me iu fol ktyne, që me iu thanë jom shqiptar, as s’guxojsa kurgjo”. Për fat e zatet ni dajë t’babës t’vet në qytet, po ai daja jo me e njoftë me këtë veshje kta, po ky e njeh ata. E ai daja në treg ish kanë, kish pasë qenë ditë tregu në Mitrovicë atë ditë edhe ky i fol dajës t’vet ata... edhe tash e marrin vesh që është shqiptar. Kur e marrin vesh që është shqiptar, “S’janë bo”, tha, “dhetë minuta m’i kanë hjekë”, tha, “ato tesha m’kanë pru tesha tjera me veshë tonat”. Edhe e kanë përcjellë tani deri ka ardhë te shpia. Mirëpo, mas dhjetë dite iu ka bashkangjit brigadës së Shaban Polluzhës. Ka shku mas tyne tani ka qenë me ta.

Erëmirë Krasniqi: E prej qasaj pjese...

[Ndërpritet intervista dhe vazhdon në një pjesë tjetër të rrëfimit]

Isa Rexha: E ka pasë “Unionin” tash që është aty, që është privatizue, e ka pasë “Tre sheshirat”, e ka pasë “Rugovën”, e ka pasë “Afërdita” e cila osht’ e pashitne sot, e ka pasë Villa Gërminë që ekziston sot. Tani ka qenë “Kosova” ni hotel në Fushë Kosovë, e kanë ble kta, Deshishku. E ka pasë në Dardani, në Aktash, ka pasë pikat e veta. Po në mesin tonë ka qenë të kyçun Menza e Amortizerave që ka qenë përpara Amortizerat, tash që osht’ Devolli aty, ka qenë Menza e Naperdakut mobile që kanë punu atu, ka qenë Menza e Postës, domethanë punëtorët tonë i kanë majtë ato menza. I kemi majtë na deri në ‘89-tën kur kanë hy masat e dhunshme.

Erëmirë Krasniqi: Akronim për çka është SLOGA?

Isa Rexha: SLOGA, hoteleri domethanë. P’i serbishtes kur kthehet shqip osht’ hoteleri, bashkim. SLOGA osht’ bashkim. E mas luftës na ia kena ngjitë Kompania Hoteliere Turistike Kosova e atëherë ka qenë Kompania Hoteliere Turistike Sloga. Bashkim i hotelerisë, në qat’ kuptim është SLOGA.

Erëmirë Krasniqi: E qysh u shpërfaqën qito masat dhunshme në SLOGA? Çka ken’ ndryshimet që fillutë me i vrejtë?

Isa Rexha: Prej ‘81-tës...

Erëmirë Krasniqi: Kufizimet a çka me iu thanë?

Isa Rexha: Prej ‘81-tës, ma qetësim në Kosovë nuk ka pasë. Kohë mas kohe janë shfaq protesta, janë shfaq demonstrata rrugës. Rehati në Kosovë s’ka pasë as prej shqiptarëve. Mirëpo pat’ fillu me të madhe me bo ni presion të madh direkt Serbia në popullatë shqiptare ktu në Kosovë. Mirëpo, atëherë linden organizata, LDK-ja, e linden do... edhe Sindikatat e shqiptarëve. Fillunë protestat e mdhaja. U kanë se kush nuk shkon me 1 shtator... mos me shku në punë kërkush me bojkotu krejt shqiptartë kush nuk shkon me qit prej pune, fillunë mos me shku nëpër puna. Edhe filloi Serbia me i shti masat e dhunshme nëpër organizata, atëherë s’ka pasë private të gjitha kanë qenë shoqënore, edhe i ka shti masat e dhunshme drejtoritë edhe drejtorat i ka zgjedhë Kuvendi i Serbisë për Kosovë.

E tash po flas për ktu te na kur i kanë pru. I kanë pru masat e dhunshme, kanë ardhë... ni serb, ka qenë malazez njo. Ai malazezi nuk i ka pranue se osht’ ni... ka qenë ni Jovica Ivanqeviq i cili në ‘74-tën... se unë e njoh, e kom njoftë për shkak të vendit të punës që e kom pasë, e kom njoftë shumë detajisht atë Jovicën. E kom njoftë edhe e kom ditë kush është. Në ‘74-tën osht’ i vetmi, plus i ka tre vetë, po ky është kryetari që i ka çu Titës letër i ka thanë, “Kujdes çka po bon me Kosovën” kur ia ka dhanë autonominë në ‘74-tën. Në ‘89-tën kur filloi Kuvendi i Serbisë me i pru masat e dhunshme në Kosovë, ky është i vetmi prej serbëve, malazez ka qenë... kom ni që ka vdekë sa është e vërtetë s’e di. Osht’ i vetmi që i ka çue letër Milloshit edhe e di që i ka çue letër edhe i ka thanë, “Je shumë i vonë edhe je shumë gabim” edhe u kanë kundër masave të dhunshme. S’ja ka pranue masat e dhunshme. Edhe pse ka qenë malazez, ata e kanë çue ni tjetër malazez. Malazez ka qenë edhe ai po ai i ka pranue masat e dhunshme të Serbisë.

Erëmirë Krasniqi: Pse s’ka qenë ai serb i Kosovës po malazez?

Isa Rexha: Ky që ka qenë përpara ka qenë malazez i Kosovës, malazez i Kosovës ka qenë. Po, po, po ka qenë banor i ktuhit, po edhe ky tjetri që ka ardhë ka qenë malazez po ka qenë, tu banu ktu edhe ky po ky i ka pranë masat e dhunshme që i ka dhanë Serbia. Ka pranë që qysh të thuni ju une punoj. Kanë përdorë tulifare metodash për me largue njerëz prej ktuhit. Deri...

Erëmirë Krasniqi: A kanë përjashtu njerëz prej punës ktu?

Isa Rexha: Po, po, po, po. Dikun prej 800 punëtorëve që kanë qenë... kur flas 800 punëtor flas në nivel të SLOGA-s, janë 18 pika. Veç në Grand kanë qenë dikun 380 punëtor, veç në Grand qitu...

Erëmirë Krasniqi: Shqiptarë, a në përgjithësi?

Isa Rexha: Po kanë qenë dikund, 10 përqindshi ka qenë serb, hajde p'e marr edhe turq, rom e diçka, 20 përqindshi e 80 përqindshi kanë qenë gjithmonë shqiptar. Po flas prej '74-tës e knena që osht' bo përmirësimi i strukturës. Tash është dashtë me largu se kanë prurë serb edhe prej atjehit, p'i Serbie e kah mosit me shti nëpër puna ksajde. Iu kanë premtu rroga t'mira. Kanë përdorë tulifar metodesh. Derisa nuk mujshin me i largue ndryshe, e bon do garderojë me katër syha [S]që i ka në flamur Serbia...

Erëmirë Krasniqi: Aha, katër S-ja.

Isa Rexha: Po katër syhat që i ka ata. Tash, mos ta thom une çka domethanë. Edhe i veshën, pjesën e garderojë në setra në qit pjesë {tregon me duar}, që m'u dokë. E tash katër kryqet, katër syhat asnjë s'ka dashtë me i vesh. Neve që kemi qenë nëpër zyre, administratës, po flas konkretisht për veti nuk m'u osht' ofru ajo për me e vesh. Kamarierve, kuzhinjerëve, pastruesve... ni pjesë, jo krejtve. Ni pjesë, po. Kujna iu ka ofru i kanë largu me qata katër syhat që i ka pasë qitu {tregon me duar} edhe s'i kanë vesh. Ni furrë në '94-tën, ni furrë prej Italie, furrë buke e pruni Arkani ktu, se ish edhe mungesë e madhe e bukës në atë kohë. Edhe furra ka qenë, edhe sot është e vendosne poshtë, por jo ajo furrë...

Erëmirë Krasniqi: Këtu ndër?

Isa Rexha: Jo, jo. Shitja ka qenë ktu...

Erëmirë Krasniqi: Po, shitja.

Isa Rexha: Shitja ka qenë ktu. Furra ka qenë poshtë, domethanë në atë furrë e kanë marrë kur janë shkue. Furra s'osht' ma aty, ajo furra tyne. Mirëpo, bukën kur e prodhojshin, bukën që kta e prodhojshin për mos me ble shqiptarë kur e therrshin e bojshin me kryq, me kryq. Domethanë, buka qysh osht' kështu {shpjegon me duar} e therrshin n'këtë anë ia bojshin katër pesë rena edhe e therrshin në këtë anë me kryq edhe shqiptarë durojshin uni. Kish bukë të mjaftueshëm me ble ktu edhe s'blejshin bukë. Shitja ka qenë qitu poshtë, menihere qitu ka qenë shitja. Në kohën e Arkanit ktu janë sillë...

Erëmirë Krasniqi: Qysh erdhën ata në '94-tën? Veç u bartën me jetu ktu a qysh, qysh u bartën?

Isa Rexha: Arkani ka qenë i ktuhit. Arkani i ktuhit ka qenë...

Erëmirë Krasniqi: P'e di, p'e di po në Grand qysh...

Isa Rexha: Po erdh me jetue...

Aurela Kadriu: A e mbanë në mend qat' ditë qysh...

Isa Rexha: Ah jo, kanë ardhë kah njo kah njo. Ai ka ardhë, ka ardhë me atë grupen e vet, Arkani. Edhe Arkani ka qenë i ktuhit, banor i Kosovës, cilit vend saktë t'rrej se s'e di. Atëherë kanë fillu me u ashpërsu ndaj shqiptarëve shumë senet. Kanë largu me të madhe, qe besa edhe kanë rreh, kanë rreh. Edhe qysh në atë kohë kanë fillu menihere Zoran Angjellkoviqi¹ ka ardhë edhe osht' bo banor i Hotel Grandit bash në rezidencën e Titës. Përballë është ni rezidencë tjetër, n'këtë anë {tregon me duar} edhe ajo është e Titës, po s'u qujtë atëherë e Titës se ka qenë kjo e madhja. Ka flejtë ky, Arkani me bandën e vet. Kanë flejt aty. Ktyne iu kanë ble mobile të veçanta prej Simpos edhe kanë jetu ktu...

Erëmirë Krasniqi: A nijshi presion? Meqenëse ai ish aty.

Isa Rexha: Kamarietë, kuzhinierët, kta që kanë pasë kontakte me to, sidomos kamarietë po. Mirëpo, ata kanë hi edhe nëpër kuzhina. Kanë pasë presion edhe i kanë largu pjesën dërmuese. Domethanë, prej se... se edhe ma herët deshta me cekë, prej 820 punëtorëve, saktë s'jom i sigurtë veç 820 mujnë me kanë 822-823 s'kanë mbetë, kemi pasë mbetë 72 shqiptarë në nivel të SLOGA-s pjesa dërmuese u bo serbë krejt. Domethanë, prej 820 punëtorëve kanë mbetë 72 punëtorë që kanë mbetë... po flas për '95-'96 deri në '97-ën kur e kom lshue. Kemi qenë...

Erëmirë Krasniqi: A vishin shqiptarë myshteri?

Isa Rexha: Jo, jo, shumë pak. Mirëpo në atë kohë kanë qenë shumë gazetar të jashtëm, kanë qenë shumë ambasadorë të jashtëm, diplomat të jashtëm që e kanë përcjellë situatën...

Erëmirë Krasniqi: A ka ndodhë najherë naj incident mrena?

Isa Rexha: Po. Kanë rreh punëtor shumë ose e kanë njoftë në rrugë, e kanë marr në rrugë e kanë pru e kanë rreh ktu, ka ndodhë shumë. Mirëpo, nuk e di. Me personel fort s'kanë pasë, i kanë largue m'i rreh s'i kanë rreh, me largu i kanë largu automatikisht. Se s'kanë dashtë me ua ditë gjendjen ku janë, tek janë, kur janë, kur s'janë ktu. Domethanë, kanë dyshue edhe s'kanë dashtë me ditë kur janë tek janë. A dikur që... veç pak iu kanë tek me e rreh dikanin, prej rrugës e kanë marrë e kanë shti e kanë rreh ktu edhe e kanë qit në rrugë prapë.

Erëmirë Krasniqi: Cilën pjesë e kanë përdor?

Isa Rexha: Zakonisht i kanë përdorë bodrumet poshtë, bodrumet poshtë. Çka mas luftës dyshohet që n'pjesën e kugllanës ku thashë ka ekzistë në atë kohë dyshohet që ka pasë do njerëz t'djegun aty. I ka marr KFOR-i do mostra, do pluhna, do ktu... mirëpo kurrë kurfarë përgjegje s'na u ka dhanë çka ka aty, çka ka pasë, çfarë pluhni është ai, çka është djegë aty. Kugllana me thanë është pesë kat poshtë krejt ktuhit.

¹ Folësi mendon në Željko Ražnatović - Arkan, mirëpo e thotë një emër tjetër.

Erëmirë Krasniqi: E qysh janë dokë? A kanë qenë civil kjo grupa e Arkanit apo...

Isa Rexha: Krejt civil, krejt civil. Domethanë, mrena në Grand kanë qenë... njerëz Grandi nashta ka pasë njerëz me uniforma të ndryshëm apo diçka. Ktu kanë qenë krejt civil mrena, s'ka pasë asnjë në uniformë.

Erëmirë Krasniqi: A e din çka kanë bo ktu? Po mendoj e dijmë çka kanë bo ata po a ishin tu e shtru terenin? A ishin tu marr t'dhana për çka o' tu ndodhë ktu...

Isa Rexha: Ata e kanë vëzhgu terenin ku kanë pasë nevojë kështu me intervenu kanë interevnu, ku kanë mujtë kanë mledh gjin [njerëz] kanë rreh në tona antë jo veç ktu po n'ona antë. Po, të tregova edhe ma herët Zoran Anxhelkoviqi ka pasë dhomën ktu, ka qenë banor i përhershëm i Hotel Grandit. Ai ka qenë mbi ushtri e mbi ktu ka qenë po ktu e ka pasë komandën. Edhe në kohë të luftës, thashë, me polici, me ushtri krejt janë kanë të vendosun në Grand. Mirëpo, Grandi për fat nuk është bombardu apo diçka. Njejta gja qysh une e kom përjetue, në fillim kur kom hi që ka qenë Grandi, njejtën gja kom përjetue prej '99-tës kur jom hi. Se jom...

Erëmirë Krasniqi: Qysh e lat'... t'mos dalim qaty meniherë... qysh e lat' punën në Grand? Qysh vendosët me shku në '97-tën?

Isa Rexha: Fillunë presionet, fillunë, "Ju jeni UÇK, ju jeni ktu..." atëherë une jom tërhjekë edhe jom dalë jom aktivizu në UÇK. Kom qenë në UÇK, deri në... me 11 gusht, me 11 qershor. Jam i pari shqiptar që kom hi ktu në Grand, kom hi civil, i pari shqiptar. Edhe... me thanë jom i mrami që kom dalë...

Erëmirë Krasniqi: Pse nejtët?

Isa Rexha: Jo, pse une i kom ditë t'gjitha gjanat i di në Grand, çdo sen. Mos të thom edhe me lugë sa ka pasë Grandi e kom ditë. Se une i kom kry gjithmonë barazimet, regjistrimet, barazimet. Nuk ka pikë në Grand që une nuk e njoh në detaje. Ma mirë i njoh, po flas kështu, dhomat une se që i njeh nikoqirja, ma mirë e njoh depon une se që e njeh depoisti apo e ka njoftë depoisti, ma mirë e kom ditë une çka ka në depo se që e ka ditë depoisti apo kuzhina inventarin e vet të cilin e ka përdorë. Se une jom përmeqat çdo muj s'paku, ni herë n'mujtë me to regjistrime barazime, domethanë...

Erëmirë Krasniqi: I keni pasë edhe lurtë e juja? Masi i përmende lurtë, i keni pasë lurtë me *brand*, mbishkrime. Kush ua ka maru ato?

Isa Rexha: Po, ato na i kemi porosit ato i kemi pasë po tash masi veç po don me ditë për inventarin, në kohën kur është maru Grandi, Tita, po flas apet për Titën, e ka pru inventarin e vet për 300 persona krejt n'flakë të argjendit. Invertari i argjendit për 300 persona. Do të thotë... kur thom për 300 persona me t'gjitha, me përjashtim çka s'kanë mujtë me u bo në flakë të argjendit janë kanë kristal. Kristal i klasit t'parë. Inventarin në flakë të argjendit e ka punue "Famipa" e Prizrenit, "Famipa" e Prizrenit. Po t'thom, ni kujdes shumë të veçantë çka realiteti qysh osht' osht' mirë me pranue, ni... shumë osht' e veçantë që inventarin fisnik na e kemi qujtë ktyneherë argjend, fisnik, osht' përcjellë nga policia sërbe çdo gjashtë muj iu ka bo regjistrimi. Nuk ka guxoftë me mungue as një send. Tash na mujna me thanë e kanë marr, po jo binduni që se ka marr as ni send.

Kur jemi kthyer mas lufte e kem bo regjistrim ma së pari... se tash, po m'bjesh tash me fol diçka... se tash masi po hi mas lufte po tregoj diçka për biografinë time. Përpara kur kom ardhë une ktu ka qenë ni, n'fillim, ka qenë qai që ka qenë drejtor ktu që e hoqën masat e dhunshme u vnu mas masave të dhunshme, ni Milan Gjureviqi, serb i ktuhit edhe kur jom ardhë une u kanë ai drejtor ktu. Domethanë, kur jom ardhë ma së pari ka qenë ktu edhe kur jom ardhë mas lufte ka qenë ktu. Edhe ka qenë ni ndërmjetësues në mes serbëve dhe shqiptarëve në... [i bën telefoni] Uh, i jemi, i jemi.

Pjesa e Tretë

Isa Rexha: E kur kom ardhë ktu... tash ndërmjetësuesit mes serbëve edhe shqiptarëve për me hi në punë tash ktu me u kthyer shqiptarët, ka qenë ni anglez oficer, Bernard e qujshin. Beneti, Beneti. Edhe m'kanë thirrë mu si qitu ku hini ma herët {tregon me duar} osht' drejtori gjeneral që u kanë në nivel të SLOGA-s. Tash është drejtori jonë qitu tash. Edhe m'kanë thirrë qitu, domethanë kanë qenë drejtori që ka qenë i emrum, serbi, edhe ka qenë ai që ka ardhë përfaqësuesi i shqiptarëve Zekë Çeku, tash merret me hoteleri e turizëm, kom shumë respekt për to. E tash më thirrën mu për me bo koordinimin e ni komisionit për regjistrim, pranim, dorëzim në mes serbëve dhe shqiptarëve, se ai Gjuroviqi dojke me shku në pushim, e lypke pushimin vjetor.

Erëmirë Krasniqi: Dojke me shku në pushim qatëherë meniherë mas luftës a?

Isa Rexha: Meniherë mas lufte. Po s'ju punojke me shqiptarë, dojke me shfrytëzu qat' rast. Edhe m'kanë thirrë mu qitu në zyre, edhe ai Beneti p'i thotë atij serbit, p'i thotë, "Cakto ti dikon anëtarë të komisionit për pranim-dorëzim të objektit, se duhet me ia dorëzu Zekës". E tash une po... e ai Gjuroviqi m'njofke mirë edhe në kohën e tij kom kry regjistrime edhe m'njofke mirë. Tha, "Prej anës tonë..." tha, "osht' Isa Rexha i caktum" Gjuroviqi më njofke mirë. Tha, "Prej anës tonë..." tha, "osht' Isa Rexha i caktum" Gjuroviqi.

Po i drejtohet tash Zekës, ai i shënojke në fletore, tha, "Cakto komisionin prej anës tane, kryetar komisioni kond e cakton?" Edhe Zeka më njofke se kom punu '85-'86 me Zekën edhe Zeka më njofke mirë. Tha, "Edhe prej anës tonë Isa Rexha". "Mirë". Po i drejtohet ktij Gjuroviçit i tha, "Anëtarin e dytë?" Ai tha, "Edhe prej meje, anëtari i dytë, Isa". I drejtohet Zekës, drejtorin e Grandit, a keni ni ju për to Sabri Mikullovc. P'i thotë ktina serbit, p'i thotë, "Anëtarin e tretë?" Po i thotë Zekës, s'thojke cakto, ecke ai s'pritke. Tha, "Të tretin?" E caktoi ai ni Ajvaz Ramën.

Të parën punë që iu interesojke shqiptarëve, me bo arkën. Shkum e bonum arkën, i gjetëm 44 mijë marka, pare aty, marka po flasim. Edhe puna e dytë, që mu më ka interesu edhe që e kom ditë që duhet me u bo ka qenë depoja e inventarit fisnik apo të argjendit. Edhe kom shku kom bo regjistrim. Edhe e kom marr regjistrimin e '86-tës kur kom bo me 31.12 në fund të vitit edhe e kom bo krahasimin e '99-tës domethanë kur kemi hy na ktu kur jemi kthyer na shqiptarët. Besoni që dy gota të kristalta

mungojnë veç. Ato që kanë qenë të argjendta s'mungojnë kurrë ni sen.d Osht' pleku ma i madh se kjo tavolinë komplet që ka qenë i punun në flakë të dukatit...

Erëmirë Krasniqi: A janë ato hala, a veç në qat' moment kanë ekzistë?

Isa Rexha: Tash për fat të keq ni pjesë e madhe nuk janë. Edhe kto ndodhin krejt mas privatizimit. Edhe jo mas privatizimit që e merr privati, privati i ka marr, mos të thom disa prej... ni mesë bre nuk po më len rehat [i drejtohet intervistuesëve].

Erëmirë Krasniqi: Përgjigjuni.

[Intervista ndërpritet që i intervistuari të flet me telefon]

Pika domethanë e fundit e SLOGA-s, hala nuk janë shitë do po Grandi si Grand osht' shitë me 10 gusht 2006-ën. Mirëpo, zyrtarisht ata kanë pasë kohë me i bo pagesat edhe tre muj ditë. Kështu që, me 13.10-tin zyrtarisht kanë hi në Grand, privati ai ktu.

Mirëpo, po flas para lufte, domethanë mas lufte ku kem te depoja e inventarit fisnik s'ka mungu kurgjo, dy gota të kristalta. Mas privatizimit, ky privati i ka marrë, mos të thom, prej gotave ni gotë, prej lugave ni lugë, ni thikë, ni pirun, ni pjatë... prej kureshtje me pa, deri ata mbajtëset e qirave janë kanë flakë të dukatit. Ne gjithmonë në depo, depon e kemi qujtë si depo e inventarit fisnik. Mas marrjes së privatnikut që ia kanë marrë apet AKP-ja, mungon ni pjesë mos të thom dikun, afër 50 përqindshi mungon.

Erëmirë Krasniqi: 50 përqindshi?

Isa Rexha: 50 përqindshi mungon.

Erëmirë Krasniqi: Kush i ka marrë, a qysh, a çka ka ndodhë?

Isa Rexha: Po tash kush i ka marr...

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj çka ka ndodhë? Çka po supozoni që ka ndodhë?

Isa Rexha: Po si rasisht çelen depot natën, nuk thehet kurgjo. Çelet edhe mshelet depoja thatë, pa u thy kurgjo dhe mungon inventari. Po thom...

Aurela Kadriu: A ka mungu krejt menihere qai 50 përqindsh?

Erëmirë Krasniqi: A gradualisht?

Isa Rexha: Jo, jo gradualisht, gradualisht. Osht' thye nihere kom raportu që është thye, njo osht' thye. Kom raportu që është çelë edhe osht' marrë, mungon qiky inventar fisnik. Pa kurrfarë reagimi, çka osht' dashtë me reagu AKP-ja, u dashtë me reagu. Se thashë ma herët, në kohën e serbëve e kanë bo serbët regjistriminçdo gjashtë muj. Në kohën e shqiptarëve, do të thotë pas luftës, se e shqiptarëve ka qenë edhe para luftës, në vitet e '80-ta deri '89-tën s'ka mungu kurgjo se osht' bo regjistrimi, po s'ka mungu kurgjo.

Në kohën e shkive edhe '89 deri në '99-tën s'ka mungu kurgjo, mungon tani e knena. S'reagon kurgjo. Edhe e shohin punëtortë që s'po reagon kurgjo, fillon me mungu prapë e prapë e parapë. Edhe kanë mungu disa gjana bukur shumë. Mungojnë. E kom edhe listen saktë edhe çka mungon. Osht' i pavlerë... se osht' ardhë ai inventar në '78-tën, reputacion i Titës ka qenë. Me faturë të Titës. "Famipa" e Prizrenit krejt e ka punu ata me kristal me të argjendtë.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë shumë edhe artistë t'cilët kanë punu vepra për dhoma? A e dini historinë e qatij koleksioni të artit që është mbledhë në Grand?

Isa Rexha: Janë të deponune ni depo nëse nuk gaboj në dhomën 309, janë nën mbikqyrje të Ministrisë së Kulturës. I ka tubue me ni dhomë. Me përjashtim qikjo tepih, qiky qylym edhe qajo piktura sofa që janë hala të vjerrna në mur. Përndryshe të tjerat t'gjitha janë të deponune në ni dhomë, aty ni depo.

Erëmirë Krasniqi: Çka është statusi i tyre?

Isa Rexha: Ministria vendos për to, na s'kem kurgjo veç na ka shti m'i tubu.

Erëmirë Krasniqi: A kanë qenë pronë a ka qenë inventar edhe i Grandit?

Isa Rexha: Po, po, po kanë qenë. Po ato kanë qenë, ma shumë kanë qenë të... si dhurata për Grandin. Mirëpo, kanë qenë me ni mënyrë edhe të pagume. Kanë qenë edhe të pagume. I kemi edhe dy skulptura të cilat janë, njana është në kat qitu, njana është poshtë te recepsioni. Kjo në kat është prej drurit e atje poshtë është prej bronzit, te recepsioni, që edhe ato janë të pagume. Ky Çavderbasha, kjo familja e tyre po tentojnë m'i marrë, mirëpo unë besoj që s'kanë të drejtë me i marrë se janë të pagume në atë kohë gjithçka. Se Grandi ka pasë pare, janë të pagume gjithçka.

Erëmirë Krasniqi: E tash e kanë nifarë statusi të trashëgimisë kulturore, a qysh?

Isa Rexha: Po, i kanë marrë. Ministria i ka marrë nën mbikqyrje edhe i ka aty. Vjen së paku niherë në vjet edhe i bon regjistrim, nëse mungon diçka apo s'mungon diçka.

Erëmirë Krasniqi: A janë damtu ato, a mundesh me na kallxu pak?

Isa Rexha: Jo, jo, jo. Janë të rujtuna po kanë qenë gjithmonë në mur të vendosuna, kështu që s'kanë qenë nëpër tokë, s'kanë qenë të thyne. Edhe fort, mos t'thom, sa iu përket librave e pikturave shqiptartë nuk i vjedhin kto sene (qeshë).

Aurela Kadriu: A janë n'dhomë t'palune a janë...

Isa Rexha: Po, po, po. Edhe janë nën kontrollë. Po, këto s'i kanë marrë fort, s'ju kanë dashtë kërkujna si duhen. Edhe te librat s'mungojnë.

Aurela Kadriu: Çka është Grandi sot për juve? A na kallxon, çka po ndodhë, çka ndodhë sot në Grand?

Isa Rexha: Grandin sot, une mendoj se qysh prej kur u maru në '78ën e tanë Kosova është njoftë nëpërmes Grandit. E kanë gjetë Grandin, e kanë gjetë Kosovën. Sot, Grandi ka mbetë bash kërkush. Po kto kanë qenë interesa, kur ka qenë shitja kanë qenë interesa e klaneve. Ktu, kur u shitë Bozhuri, u

shitë në vlerë një milion e 650 mijë euro, 30 përqind ka qenë qiky pronari i Grandit, pesë përqind ka qenë Pacolli, pesë përqind Remzi Ejupi. Se i di une, se masi jom marrë me financa i di edhe pagesat qysh kanë ardhë.

Grandi kur u shitë 40 përqind ka qenë qiky i "Silkaporit" që e ka prodhimin e bllokave, Zylqif Berisha, 40 përqind. Po jashtë dore kështu ka qenë Pacolli edhe 20 përqind Remzi Ejupi. E tash në Bozhur, Pacolli ia ka ble aksionet krejtve, ky s'ia ka shitë aksionet. Zylqifi në Bozhur s'ia ka shitë aksionet. Pacolli edhe Remzi Ejupi kanë dashtë me qit' kta prej... janë marr vesh nihere që bllokat çka t'shkojnë për me zidu diçka ke me i marr prej ktina në fabrikë. Edhe tana kanë prish diçka raportet, s'i kanë marrë kanë dashtë me qit prej loje.

Ata e qitën prej lojës e lanë me marr pjesë në investime, ish Bozhuri tash Swiss Diamond, këtë pronarin e Silkaporit, Zylqif Berishën. Ky u mundu me i qit prej Grandit, mirëpo Grandi u kanë kafshatë e madhe për to, ky u kanë peshk i vogël për ta edhe e falimentun. Jo që nuk ndreqën Grand, po shkatërrun. Total e shkatërrun. Me dalë në atë pjesën anena është tmerr, tutni me kalu asajde.

Erëmirë Krasniqi: E fasada qysh...

Isa Rexha: Qajo fasadë veç që iu ka dhanë e jashtme, për mbrenda është krejt çka janë thy muret...

Erëmirë Krasniqi: Qysh iu doket qajo fasadë se ju jeni mësu me e pa Grandin me mermer edhe me ngjyrën e kaftë...

Isa Rexha: Po, po, po. Na jena mësu me pa mirëpo kjo është shumë e damshme ktu pllakat që janë jashtë. Meqenëse, tash edhe Ministria e Kulturës po don ni pjesë... në ni mënyrë e ka fut edhe Grandin nën mbrojtje. Mirëpo, osht' gabim, po mendoj sa i përket fasadës t'jashtme. Osht' gabim nëse nuk bohet ni investim me u shtrëngu kto pllaka. Prej '77-tës kur janë ngjit kto pllaka, kanë fillu ni pjesë me ra. 18 kilogramshe është ni pllakë. E tash llogarite me t'ra prej katit të dymdhetë, mos të thom prej të tretit po prej dymdhetit. Na kanë ra qitu përpara në beton në pllaka kanë ra e kanë bo birën deri gjysë metre fell, ni pllakë që ka ra. Për ata i kemi ngjitë do mrezha, rrjeta t'hekrit qitu përpara, që nëse bjen mos të bjen, mos të bjen mbi mysafir po t'i nalet shpejtësia, t'i nalet forca, t'thehet, copa t'vogla le t'bijnë tash s'ki çka i bon. Domethanë për ata janë ngjitë ato rrjeta jashtë, qysh moti i kemi ngjitë.

Në vende të zhvillume, në perëndim ni kat, ma tepër nuk lejon pllaka. Jo, jo. Munet me iu dhanë fasadë po me iu dhanë me ngjyrë të njejtë m'u dokë si pllaka, me u bo si mermer se ky është mermer nuk është lojë. Mirëpo, kur llogaritet, 18 metra... se kta janë të kapun edhe me shrafa, kto pllaka po janë të kapne edhe me ciment. E ti tash llogarite me t'ra njo, 18 kille me t'ra prej s'nalti, aty deri t'vjen poshtë t'i bon 500 killa apo ma shumë. E unë mendoj që nëse tenton ministria, veç e ka fut pa na pytë hiç kërkanin. Mirëpo gabon se nuk lihen ktu. Dikuj i bjen në kry e myt.

E tash e kanë shkatërru e kanë pru në qat' nivel edhe mos të thom, janë interesa personale. E kanë lshu Grantin me qira, na s'punojmë kurgjo. Unë bash kurgjo s'punoj, auditor jom, se në Grand s'ka kurgjo. Në Grand s'ka kta, në Grand s'ka siguri, në Grand është kjo, në Grand është kjo, s'kem edhe mysafir. Na i marrim do paga prej AKP-së prej qirave që pagujnë ktu. Poshtë qitu osht' "Devolli", qatje drejt... me qito zyret që janë tonat në anën anej është Pacolli. Aty i ka marrë do zyre tjetri, atje do zyre i

ka marrë tjetri. Kështu që, na prej AKP-së i marrim do qira prej tyne, i marrim rrogat prej tyne. Kanë qenë do rroga t'vogla.

Kur na kanë shti në 2012-ën në mujin e tetë ia kanë marrë, na kanë lanë me vetëfinancim, 2008 kur ia kanë marrë, jo 2012-ën m'falni. 2012-ën kur ia kanë marrë në mujin e tetë na kanë lanë... ish pronarit, na kanë lanë me vetëfinancim deri në 2015-ën. Rroga ma e ulta ka arrit me u marr 400 euro. Mirëpo, jo si pikë bazë po kem pagu përvojën e punës, kem pagu orë natë, kem pagu orë festë, kemi dhanë shpërblime. Kështu që, rroga ma e vogël ka qenë 400 euro. A bazën e ka pasë për shembull 150 euro. Në mujin e dytë 2015-ën na shtinën në likuidim. Na shtinën në likuidim, pretendun se duhet me i largu 50 përqind të punëtorëve. Ishim 98 vetë u dufke me i largu njo 60 punëtorë. Na pranum. Na kushtëzun, na kushtëzun po ma tepër ish kushtëzim për me i pranu pagat e ulëta. Se s'pe largojmë kërkanin... po pikën, për shembull, unë e kom pasë 500 euro rrogën, bazën, 250 euro rrogën 50-50. Edhe pranun punëtorët.

Erëmirë Krasniqi: A janë pagu punëtorët, a kanë marrë naj pjesë prej shitjes së Grandit?

Isa Rexha: Po. Po e kanë marrë 20 përqindshin prej shitjes së, SLOGA-s po flas se Grandi si Grand vetën jo po si Sllogë kur u shitë po. I kena marrë 20 përqindshin. S'ju ka ra naj vlerë e madhe me dhanë përgjegjësi, iu ka ra dikund kah katër mijë euro për punëtorë. Varet prej përvojës t'punës sa ka pasë po përafërsisht kah katër mijë euro për punëtor iu ka ra. Edhe tash kemi pranun qashtu. Qaq e kanë shkatërru si kur i thom dikujna që Grandi punon, "Ej, Grandi nuk punon qe sa vite". Po Grandi more punon, Grandi funksionon. I ka dhomat, i ka tonat.

S'na lojnë me u furnizu me ushqim, na i kanë mbyllë kuzhinat domethanë. Sot me na ardhë mysafirë s'kem ku me ia qit ni kafe, po mendoj ni drekë a ni darkë apo ni mëngjes. Qitu na kanë lanë ni byfe e kemi edhe për mysafirë edhe për veti TV Salla është qytë edhe quhet TV Salla. Dy salla i kena qitu për mbledhje, tjerat krejt i kanë lshu me qira. Dhomat i kemi, çka osht...

Erëmirë Krasniqi: A i shfrytëzoni kto sallat për mledhje?

Isa Rexha: Po. Çka osht' ma e keqja që internet s'ka pasë edhe s'ka. Kështu që, gazetarë e kështu t'jashtëm nuk vijnë ktu te na. Arsye se pa internet... edhe pse vjen kha, ai vjen me punë edhe kryn punë, pa internet s'mun kryn. Kështu që, s'mun vendoset te na se s'ka internet. Na i kemi çu do Wi-Fi nëpër kate mirëpo tregova që ktu është krejt beton, muret janë shumë të trasha shancë me depërtu valtë nuk kanë. Pos mysafiri duhet me dalë në koridor te Wi-Fi me u kyç, përndryshe nuk funksionojnë.

Erëmirë Krasniqi: Shumë faleminderit.